**AKTI I THEMELIMIT**

**I**

**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**"GMV TRADING" SHKP**

**Neni 1**
**Emërtimi**

1.1 Emërtimi i shoqërisë është "GMV TRADING" Sh.P.K., më poshtë e referuar si "Shoqëria".

**Neni 2**
**Themelimi**

2.1 Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin e saj në Regjistrin Tregtar, të administruar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

2.2 Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj në përputhje me ligjin Shqiptar, me Statutin dhe Aktin e Themelimit.

**Neni 3**
**Selia**

3.1 Selia e Shoqërisë është në adresën: Zona kadastrale nr. 8270, "Rruga "Abdyl Frasheri", Pallati"10/1" Tiranë,Shqipëri.

3.2 Shoqëria mund të hapë dhe mbajë degë dhe/ose të kryejë aktivitete në vende të tjera, brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë si dhe të hapë ose mbyllë zyra në vende të ndryshme përveç selisë së Shoqërisë brenda territorit shqiptar.

**Neni 4**
**Ortaku i Vetëm**

4.1 Ortaku i vetëm i Shoqërisë është:

**Z. Eduard MANUSHI,** shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më 17/11/1966, mbajtës i kartës së identitetit nr. 030758546, banues në adresën: "Rruga "Abdyl Frasheri", Pallati"10/1" Tiranë,Shqipëri, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar.

**Neni 5**
**Kapitali Themeltar**

5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është në vlerën 100.00 (njëqind) Lekë, i përbërë në një kuotë me vlerë 100.00 (njëqind) Lekë. Kapitali themeltar është nënshkruar plotësisht nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë.

5.2 Kuotat, me vendim të Ortakut të Vetëm, janë lirisht të transferueshme tek çdo individ ose person juridik nëpërmjet kontratës së shitblerjes, trashëgimisë, dhurimit ose nëpërmjet çdo mënyrë tjetër të parashikuara nga ligji. Transferimi i plotë ose i pjesshëm i kuotave të zotëruara në kapitalin e Shoqërisë do të kryhet me anë të një akti noterial.

**Neni 6**
**Objekti**

6.1 Objekti i Shoqërisë është, kryerja e veprimtarive të ndryshme në fushën e:

Prodhim televiziv: prodhime audio-vizive,spote;realizime evente të ndryshme artistike,fushata publiciare;realizime grafike,website etj.

Ofrim i sherbimeve grafike,dizenjim,editori,dizenjim faqe web, grafike multimediale,fushata promocionale prodhimesh, fushata sociale,packaging,reklama,ilustrime,broshura,katalogje elektronike dhe aktivitete te tjera ne fushen e grafikes,dizenjim realizime mediatike dhe marredhenie me publikun,organizim eventesh,tregti materiale per organizim eventesh ndricim,foni,dekorime,konsulence per organizim eventesh,ide per marketing dhe te gjitha aktivitetet e tjera financiare te lidhura me permbushjen e objektit te shoqerise.

Shoqeria mund ta ushtroje aktivitetin ne fushen e financave te pergjithshme perfshire huamarrjen, financen, qirane financiare, marrjes me hua, blerjes, financimit, financimit te shoqerive te reja, fnancimin e kapitalit te plote, huadhenie, huadhenie te vecante, te garantuara ose jo me pasuri te luajtshme ose paluajtshme.

Shoqeria mund te ushtroje aktivitetin si nje shoqeri investimi dhe te investoje ne, ose marre si dhurate ose tjeter dhe te zoteroje, shese, ose ndryshe te merret me aksione, obligacione, letra me vlere, obligacione dhe mjete te tjera financiare te leshuara dhe garantuara nga dhe permes ndonje shoqerie, firme ose personi te themeluar ne Shqiperi ose ndonje vend tjeter dhe te administroje investimet, aksione, stoqe dhe mjete financiare.

Shoqeria mund te ushtroje aktivitetin me pasurite e paluajtshme te tilla si : blerja, shitja, dhenia me qira dhe zhvillimi i pasurive te paluajtshme si toka, shtepi, vila, apartamente, dyqane, vende parkimi dhe veprimtari te tjera te lidhura me te siperpermendurat. Per kete qellim Shoqeria mund te lidhe marreveshje, ose kontrata qiraje, shitblerje, ose hipotekimi te pasurive te paluajtshme, kontrata kredie, sherbimi dhe marreveshje e kontrata te tjera te nevojshme per ushtrimin e aktivitetit.

Shoqeria mund te ushtroje aktivitet ne fushen e konsulences ligjore , konsulences tregtare dhe menaxheriale, si dhe te kryeje ndermjetesim tregtar.

Shoqeria mund te ushtroje aktivitet ne administrimin e zhvillimit te projekteve ne fushen ekonomike, sociale dhe edukimit, si dhe çdo veprimtari tjetër e cila i shërben përmbushjes së qëllimit të shoqërisë dhe që nuk ndalohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

6.2 Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër biznesi, i cili nuk është i ndaluar nga ligji i zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë.

## Neni 7
## Kohëzgjatja

4.1 Kohëzgjatja e Shoqërisë është për një periudhë kohore të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

## Neni 8
## Kompetencat e Ortakut të Vetëm

8.1 Ortaku i Vetëm, në përputhje me ligjet shqiptare, mund të marrë, por pa u kufizuar, vetëm në: vendime për ndryshimin e Statutit, bashkimin me shoqëri të tjera, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit, shndërrimin e shoqërisë në forma të tjera të parashikuara në ligj, transferimin e plotë ose të pjesshëm të kuotave, emërimin dhe shkarkimin e administratorit, emërimin e ekspertit kontabël, miratimin e llogarive vjetore dhe të pasqyrave financiare, likuidimin e Shoqërisë, emërimin e likuidatorit.

## Neni 9
## Administrimi i Shoqërisë

9.1 Administratori i parë i Shoqërisë është:

**Z. Eduard MANUSHI,** shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më 17/11/1966, mbajtës i kartës së identitetit nr. 030758546, banues në adresën: "Rruga "Abdyl Frasheri", Pallati"10/1" Tiranë,Shqipëri, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar.

9.2 Administratori/ët emërohet/n me Vendim të Ortakut të Vetëm për një periudhë 5 (pesë) vjeçare. Administratori (ët) mund të riemërohet (n) me Vendim të Ortakut të Vetëm të Shoqërisë për të njëjtën periudhë.

## Neni 10
## Ligji i Zbatueshëm

10.1 Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj në përputhje të plotë me ligjin shqiptar.

10.2 Çdo konflikt qe mund të lindë mes ortakëve të Shoqërisë do të zgjidhet me mirëkuptim, ne rast të kundërt mosmarrëveshja do të jetë objekt i zgjidhjes nëpërmjet vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky akt themelimi u hartua në katër kopje të njëjta në gjuhën shqipe.

Tiranë, më datë 19/06/ 2018

**ORTAKU I VETËM**

**STATUT**
**I**
**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**
**"GMV TRADING" SH.P.K.**

**Neni 1**
**Emërtimi**

1.1 Emërtimi i shoqërisë është "GMV TRADING" Shpk më poshtë e quajtur "Shoqëria".

**Neni 2**
**Personaliteti juridik**

2.1 Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin e saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

**Neni 3**
**Selia**

3.1 Selia e Shoqërisë është në adresën: Zona kadastrale nr. 8270, "Rruga "Abdyl Frasheri", Pallati"10/1" Tiranë,Shqipëri.

3.2 Shoqëria mund të hapë dhe mbajë degë dhe/ose të kryejë aktivitete në vende të tjera, brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë si dhe të hapë ose mbyllë zyra në vende të ndryshme përveç selisë së Shoqërisë brenda territorit shqiptar.

**Neni 4**
**Kohëzgjatja**

4.1 Kohëzgjatja e Shoqërisë është për një periudhë kohore të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

**Neni 5**
**Objekti**

5.1 Objekti i Shoqërisë është kryerja e veprimtarive të ndryshme në fushën e:

Prodhim televiziv: prodhime audio-vizive,spote;realizime evente të ndryshme artistike,fushata publiciare;realizime grafike,website etj.

Ofrim i sherbimeve grafike,dizenjim,editori,dizenjim faqe web, grafike multimediale,fushata promocionale prodhimesh, fushata sociale,packaging,reklama,ilustrime,broshura,katalogje elektronike dhe aktivitete te tjera ne fushen e grafikes,dizenjim realizime mediatike dhe marredhenie me publikun,organizim eventesh,tregti materiale per organizim eventesh ndricim,foni,dekorime,konsulence per organizim eventesh,ide per marketing dhe te gjitha aktivitetet e tjera financiare te lidhura me permbushjen e objektit te shoqerise.

Shoqeria mund ta ushtroje aktivitetin ne fushen e financave te pergjithshme perfshire huamarrjen, financen, qirane financiare, marrjes me hua, blerjes, financimit, financimit te shoqerive te reja, fnancimin e kapitalit te plote, huadhenie, huadhenie te vecante, te garantuara ose jo me pasuri te luajtshme ose paluajtshme.

Shoqeria mund te ushtroje aktivitetin si nje shoqeri investimi dhe te investoje ne, ose marre si dhurate ose tjeter dhe te zoteroje, shese, ose ndryshe te merret me aksione, obligacione, letra me vlere, obligacione dhe mjete te tjera financiare te leshuara dhe garantuara nga dhe permes ndonje shoqerie, firme ose personi te themeluar ne Shqiperi ose ndonje vend tjeter dhe te administroje investimet, aksione, stoqe dhe mjete financiare.

Shoqeria mund te ushtroje aktivitetin me pasurite e paluajtshme te tilla si : blerja, shitja, dhenia me qira dhe zhvillimi i pasurive te paluajtshme si toka, shtepi, vila, apartamente, dyqane, vende parkimi dhe veprimtari te tjera te lidhura me te siperpermendurat. Per kete qellim Shoqeria mund te lidhe marreveshje, ose kontrata qiraje, shitblerje, ose hipotekimi te pasurive te paluajtshme, kontrata kredie, sherbimi dhe marreveshje e kontrata te tjera te nevojshme per ushtrimin e aktivitetit.

Shoqeria mund te ushtroje aktivitet ne fushen e konsulences ligjore , konsulences tregtare dhe menaxheriale, si dhe te kryeje ndermjetesim tregtar.

Shoqeria mund te ushtroje aktivitet ne administrimin e zhvillimit te projekteve ne fushen ekonomike, sociale dhe edukimit, si dhe çdo veprimtari tjetër e cila i shërben përmbushjes së qëllimit të shoqërisë dhe që nuk ndalohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

**Neni 6**
**Kapitali i Shoqërisë**

6.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është në vlerën 100.00 (një qind) Lekë, i përbërë nga një kuotë, me vlerë 100.00 (një qind) Lekë. Kapitali themeltar është nënshkruar plotësisht nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë.

6.2 Kapitali zotërohet nga ortaku i vetëm i Shoqërisë si më poshtë:

**Z. Eduard MANUSHI,** shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më 17/11/1966, mbajtës i kartës së identitetit nr. 030758546, banues në adresën: "Rruga "Abdyl Frasheri", Pallati"10/1" Tiranë,Shqipëri, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar.

6.3 Kuotat, me vendim të Ortakut të Vetëm, janë lirisht të transferueshme tek çdo individ ose person juridik nëpërmjet kontratës së shitblerjes, trashëgimisë, dhurimit ose nëpërmjet çdo mënyrë tjetër të parashikuara nga ligji. Transferimi i plotë ose i pjesshëm i kuotave të zotëruara në kapitalin e Shoqërisë do të kryhet me anë të një akti noterial.

**Neni 7**
**Ortaku i vetëm**

7.1 Ortaku i Vetëm i shoqërisë luan rolin dhe ka kompetencat që ligji "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" ja njeh Asamblesë së ortakëve në shoqëritë e kësaj forme të themeluara nga disa ortakë.

7.2 Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm duhet të regjistrohen në regjistrin e vendimeve i cili nuk mund të ndryshohet apo të fshihet. Regjistri i vendimeve ruhet në selinë e shoqërisë.

7.3 Ortaku i vetëm brenda 3 muajve nga dita e mbylljes se vitit financiar miraton raportin e administrimit, inventarët dhe llogaritë vjetore, në se është e nevojshme pas raportit të eksperteve kontabël të autorizuar, të hartuara dhe paraqitura nga administratori.

**Neni 8**
**Kompetencat e Ortakut të Vetëm**

8.1 Ortaku i Vetëm, në përputhje me ligjet shqiptare mund të marrë, por pa u kufizuar në: vendime për ndryshimin e Statutit, bashkimin me shoqëri të tjera, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit, shndërrimin e shoqërisë në forma të tjera ligjore të parashikuara në ligj, transferimin e plotë ose të pjesshëm të kuotave, emërimin dhe shkarkimin e administratorit, emërimin e ekspertit kontabël, miratimin e llogarive vjetore dhe të pasqyrave financiare, likuidimin e Shoqërisë, emërimin e likuidatorit.

**Neni 9**
**Administrimi i Shoqërisë**

9.1 Shoqëria administrohet nga Administratori, një person fizik jotregtar, që mund të jetë ose jo ortak i shoqërisë. Ortaku i Vetëm, mund të vendosë që shoqëria të ketë më shumë se një administrator. Në këtë rast, marrëdhëniet ndërmjet administratorëve, kompetencat, të drejtat dhe detyrimet e secilit përcaktohen në vendimin e emërimit ose në statutin e shoqërisë.

9.2 Administratori i Shoqërisë është:

**Z. Eduard MANUSHI,** shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më 17/11/1966, mbajtës i kartës së identitetit nr. 030758546, banues në adresën: "Rruga "Abdyl Frasheri", Pallati"10/1" Tiranë,Shqipëri, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar.

9.3 Administratori/ët emërohet/n me Vendim të Ortakut të Vetëm për një periudhë 5 (pesë) vjeçare. Administratori (ët) mund të riemërohet (n) me Vendim të Ortakut të Vetëm të Shoqërisë për të njëjtën periudhë.

## Neni 10
## Të drejtat dhe detyrimet e Administratorëve

10.1 Administratorët ka të drejtë të:

a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Ortaku i Vetëm;
b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara Ortakut të Vetëm për miratim;
d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
e) raportojnë përpara Ortakut të Vetëm në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në Statut.

10.2 Ortaku i Vetëm mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë.

## Neni 11
## Vula e Shoqërisë

11.1 Shoqëria ka vulën e saj, ku shkruhet emri i shoqërisë, sipas kërkesave ligjore.

## Neni 12
## Bilanci dhe të Ardhurat

12.1 Viti financiar mbyllet më 31 Dhjetor të çdo viti. Administratori nxjerr bilancin me të ardhurat, fitimet e humbjet, të formuluara konform ligjit.

12.2 Është kompetencë e Ortakut të Vetëm të vendosë për krijimin e fondeve nga të ardhurat neto si dhe përdorimin e tyre.

**Neni 13**
**Shpërndarja**

13.1 Shoqëria shpërndahet në përfundim të afatit të përcaktuar në Statut ose përpara këtij afati në rrethanat e parashikuara nga ligji ose me vendim të Ortakut të Vetëm.

13.2 Shoqëria, gjithashtu mund të ndahet, përthitë ose të shkrihet me vendim të Ortakut të Vetëm.

**Neni 14**
**Ligji i Zbatueshëm**

14.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me ligjin shqiptar.

14.2 Çdo konflikt që mund të lindë mes ortakëve të Shoqërisë do të zgjidhet me mirëkuptim, në rast të kundërt mosmarrëveshja do të jetë objekt i zgjidhjes nëpërmjet vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Tiranë, më datë 19/06/2018

**ORTAKU I VETËM**

Edward Hamushi